

Protestë masive në 1 Maj:

Punëtorët shqiptarë kërkojnë dinjitet, paga të drejta dhe kushte të sigurta pune



Tiranë, 1 Maj 2025 — Në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve, Unioni i Sindikatave të Shqipërisë dhe Koalicioni Shqiptar për të Drejtat në Punë organizuan një manifestim të madh qytetar dhe sindikal në sheshin “Nënë Tereza” në Tiranë. Nën thirrjen **“Jetojmë me pagë shqiptare, paguajmë me çmime evropiane!”**, qindra punëtorë nga sektorë të ndryshëm u bashkuan për të kërkuar dinjitet për punëtorët shqiptarë dhe për të ngritur zërin kundër padrejtësive sociale dhe ekonomike që i detyrojnë çdo ditë shumë prej tyre të emigrojnë.

“Pagat në Shqipëri janë të ulëta si në Afrikë dhe çmimet e larta si në Europën Perëndimore. Punëtorët nuk përballojnë më jetesën, ndaj po ikin masivisht. Duam paga dinjitoze këtu, jo emigrim të detyruar!” – theksuan organizatorët.

Protestuesit vinin nga sektorë të ndryshëm – fasoneri, ndërtim, shëndetësi, call-center, naftë, pastrim e gjelbërim – të bashkuar në kërkesën për paga dinjitoze, kushte të sigurta pune dhe respekt për të drejtat bazë të punëtorëve. *“Kostoja e jetesës është rritur në mënyrë të frikshme, ndërsa pagat mbeten të njëjtat. Po jetojmë me paga shqiptare, por po paguajmë me çmime evropiane. Kjo nuk është drejtësi,”* – deklaroi Gertjana Hasalla nga Qendra për të Drejtat në Punë.

Ndërkohë, Gent Stroni nga Sindikata e Punonjësve të Shëndetësisë kërkoi që vendi të investojë seriozisht në punë dinjitoze dhe siguri në punë: *“Nuk mund të flasim për shëndet publik kur vetë punonjësit e shëndetësisë janë të ekspozuar ndaj pasigurive dhe paguhen në mënyrë mizerabël”*.

Në të njëjtën ditë, punëtorët e Bankers Petroleum në fushën naftëmbajtëse të Marinzës (Fier) protestuan për rritje pagash, bonusë të merituar dhe kushte më të mira pune, në një aksion të organizuar nga Sindikata e Sektorit të Hidrokarbureve. *“Kompania shpenzon për publicitet, por harron se pasuria më e madhe janë vetë punëtorët”*, – theksoi Dritan Shahu, kreu i sindikatës, duke denoncuar edhe mungesën e vëmendjes mediatike për këtë protestë.

Manifestimi u zhvillua në kuadër të një klime të rënduar socio-ekonomike, ku emigrimi masiv, informaliteti, mungesa e sigurimeve shoqërore dhe shfrytëzimi i punës së grave e të rinjve mbeten plagë të thella të tregut të punës shqiptar. Ndërkohë, fushata elektorale për zgjedhjet parlamentare nuk ka ofruar asnjë propozim serioz për përmirësimin e jetës së punëtorëve.



Protesta adresoi një sërë çështjesh urgjente, përfshirë:

►Kërkesat kryesore të manifestimit:

- ✓ Rritje reale të pagave dhe pensione, në përpjesëtim me rritjen e çmimeve.
- ✓ Luftë ndaj informalitetit në punë, veçanërisht në sektorin privat, ndërtim dhe fasoneri.
- ✓ Fuqizim të sindikatave dhe kontratave kolektive, jo marginalizim i tyre; përfshirje në dialogun social dhe procesin e politikëbërjes.
- ✓ Hapje të vendeve të reja të punës, në veçanti për të rinjtë dhe përmes mbështetjes së bujqësisë dhe blegtorisë.
- ✓ Subvencione për fermerët dhe garantim i shitjes së produkteve bujqësore.
- ✓ Rritje të menjëhershme dhe të drejtë të pensione, jo vetëm për efekte propagandistike.
- ✓ Masa serioze për sigurinë në punë, sidomos në ndërtim dhe në miniera, ku numri i aksidenteve po rritet çdo vit.

Sipas të dhënave të raportuara në tubim, vetëm në vitin 2024 kanë humbur jetën 33 punonjës në vendin e punës, një shifër alarmante për një vend me një treg pune të vogël. Shkaktarët kryesorë janë mosrespektimi i detyrimeve për trajnimin mbi rreziqet në punë, mungesa e deklarimeve të aksidenteve nga punëdhënësit dhe kontrolli i dobët nga institucionet.

“Qeveria kërkon vetëm të mbledhë taksa, por nuk kontrollon as kushtet e punës dhe as zbatimin e ligjit. Punëdhënësit shpesh fshehin aksidentet, duke shkelur hapur ligjin dhe duke rrezikuar jetën e punëtorëve. Ky është krim!” – theksoi Kondi Ilia, Koordinator Kombëtar i Unionit të Sindikatave.

Në fjalën e tij, z.Ilia dënoi edhe presionet dhe politikat ndaj bizneseve të reja: *“Qeveria i sanksionon që në ditët e para me gjoba dhe kontrolle arbitrare, duke dekurajuar çdo iniciativë ekonomike dhe punësim të qëndrueshëm”*.

►Thirrje për UNITET dhe VEPRIM

Organizatorët bënë thirrje për unitet të punëtorëve, sindikatave dhe qytetarëve, duke kërkuar më shumë aktivizëm dhe kurajë për të kërkuar të drejtat. *“Punëtorët nuk duhet të kenë më frikë të protestojnë. Nëse ndihen të papërfaqësuar, të bashkohen me sindikatat! Së bashku, mund të fitojmë të drejtat që na takojnë.”*

Në përmbyllje, Unioni i Sindikatave të Shqipërisë i bëri thirrje kryeministrit dhe qeverisë që të nisin urgjentisht një dialog të sinqertë dhe gjithëpërfshirës me sindikatat, sepse *“nuk ka demokraci pa përfshirjen e punëtorëve dhe sindikatave në vendimmarrje”*.